



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/53

Datë: 31.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-016, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr.12/31 të datës 25.08.2021 si dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 10,860,000 €, (dhjetë milionë e tetëqindëgjatëdhjetë mijë euro), për zbatimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike për masën 4.6 - Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", në nën-programin "Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP" me kod 23300, për subvencionim të ndërmarrjeve publike, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka pranuar kërkesë për mbështetje të ndërmarrjeve publike Telekom Sh. A. dhe Trepça Sh. A. për mbulimin e obligimeve financiare. Ministria e Ekonomisë, përkatësisht Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP, po ashtu ka konstatuar se këto kërkesa janë të arsyeshme dhe se mbështetja për këto ndërmarrje është e nevojshme të jetë në vlerë prej 10,000,000 € (dhjetë milionë euro) për Telekom Sh. A. dhe 860,000 € (tetëqindëgjatëdhjetë mijë euro) për Trepça Sh. A.

Kërkesa nga Telekom Sh. A. konsiderohet e arsyeshme dhe është mbështetur nga Ministria e Ekonomisë sepse kjo shumë nevojitet për mbulimin e obligimeve financiare ndaj Autoriteti Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), përndryshe rrezikohet marrja e licencës së Telekom Sh. A. dhe siguria e operimit të infrastrukturës kritike.

Kurse kërkesa nga Trepça Sh. A. konsiderohet e arsyeshme dhe është mbështetur nga Ministria e Ekonomisë sepse kjo shumë nevojitet për mbulimin e një pjese të obligimeve financiare ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), përndryshe rrezikohet leja e punës për flotacion të Trepça Sh. A. nga Komisioni Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/53

Datë: 31.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M


1. Shfuqizohet pjesërisht Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 17/20, i datës 24.03.2015, për kërkesën e deklarimit dhe ekzekutimit të dividendës nga Ndërmarrja Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh. A. (PTK), ku vlera e dividendës së kërkuar zbritet nga 30.000.000,00 € (tridhjetë milionë euro) në 15.000.000,00 € (pesëmbëdhjetë milionë euro).
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpërmjet Vendimit Nr. 17/20, të datës 24.03.2015, Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtrimit të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës, kishte marrë vendim që të obligojë Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh. A. (PTK) që të deklarojë dividendë për aksionarin në shumë prej 30.000.000,00 €, (tridhjetë milionë euro), dhe të paguaj këtë shumë në mënyrë periodike brenda vitit 2015. Nga data e marrjes së këtij Vendimit, PTK ka paguar vetëm 15.000.000,00 €, (15 milionë euro), pagesë e cila është kontestuar në instancat gjyqësore nga kjo ndërmarrje publike. Ndërsa pjesa e tjetër e dividendës nuk është paguar dhe kjo figuron akoma si obligim financiar i ndërmarrjes.

Marrë parasysh gjendjen financiare të PTK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës vendos për shfuqizimin e pjeshëm të Vendimit të Qeverisë Nr. 17/20, duke shfuqizuar vlerën prej 15.000.000,00 € (15 milionë euro) të dividendës së kërkuar. Andaj, është vendosur për sipas dispozitivit të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Bordit të Drejtorëve të PTK-së
- Arkivit të Qeverisë